



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 02.06.2025  
Numër Protokolli: 3746/2025

A.nr.573/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.573/2025 të datës 01.04.2025 të parashtruar nga ankuesi F.F., kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.06.2025 mori:

## V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa A.nr.573/2025, e datës 01.04.2025, e parashtruara nga ankuesi F. F.

## A r s y e t i m

Ankuesi F.F.(*tutje referuar vetëm* ankuesi), përmes e-mailit zyrtar [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net) me datë 01.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokolli 2130/2025, nën shenjë A.nr.573/2025, kundër Njoftimit me numër protokolli 291 të datës 10.03.2025, të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 14.04.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues të Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 16.04.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 3197/2025 të datës 15.05.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën e parashtruar me datë 01.04.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Këshillit VK/2025 i datës 15.05.2025; Njoftimin e datës 10.03.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të SHKK-së; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kontratën e punës të datës 20.09.2018; Formularin e vlerësimit të rezultateve të punës të datës 09.01.2024 dhe të datës 12.02.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.04.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 16.04.2025; Listat e pagave të ankuesit;

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi sipas Kontratës së punës të datës 20.09.2018 është i punësuar në pozitën “Mbikëqyrës i Lartë” në Qendrën Korrektuese në Dubravë, në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Si rrjedhojë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, përmes me shkresës numër protokolli 291 të datës 10.03.2025, e ka njoftuar të njëjtin për ekzekutimin e masës disiplinore “*Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu edhe rritjen e shkallës së pagës për periudhën për tre vjet*”.

Ankuesi kundër Njoftimit të datës 10.03.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të SHKK-së, ka parashtruar ankesën në Këshill me pretendimet ankimore se akti në fjalë cenon parimin e mosdiskriminimit në pagë, paraqet aplikim të gabuar të së drejtës materiale, shkelje esenciale procedurale, dhe vërtetim të gabuara dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me arsyetimin se nuk janë përmbushur parakushtet ligjore nga nenin 143 paragrafi 2 të LPPA-së, ndërlidhur me paragrafin 3 të nenit 153 të të njëjtit ligj, veprimi i tillë është në kundërshtim me parimin e parashikueshmërisë, dhe si i tillë veprimi i Njesisë së Burimeve Njerëzore bie ndesh edhe me neni 3, paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Thënë si më lartë, Kolegji i këshillit gjatë analizimit të aktit të kontestuar, respektivisht Njoftimit të datës 10.03.2025, si dhe analizimit të bazës së të dhënave nga lëndët e shqyrtuara ndaj ankuesit në procedura të tjera, konstatoi se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues, me datë 27.06.2024 përmes Vendimit me shifër KDI08/2024, ankuesit i ka shqiptuara masën disiplinore “*Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë tri (3) vjet*”, për shkak se i njëjti kishte kryer shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara nga neni 58 paragrafi 3, nën paragrafi 3.4 dhe 3.12 të Ligjit Nr. 08/L-131 Për Shërbimin Korrektues të Kosovës, si dhe nenit 56 paragrafi 4, nën paragrafi 4.1, 4.4, dhe 4.20 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Ankuesi, asaj kohe kishte iniciuar procedurë administrative, duke parashtruar ankesë në Këshill kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 27.06.2025, mirëpo këshilli përmes vendimit A.nr.1125/2024 të datës 13.09.2024 e kishte refuzuar ankesën e ankuesit të datës 22.07.2024, ndërsa kishte lënë në fuqi Vendimin e Komisionit Disiplinor të SHKK të datës 27.06.2024, andaj duke marrë përbazë dispozita e aplikuara të nenit 21 paragrafin 1, nenit 22 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, ku përcaktohet se: *“1. Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës; 2. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.”*, ndërlidhur me nenin 144 paragrafi 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës.”*, prandaj mbi këtë bazë Kolegji i këshillit konstatoi se Njoftimi me numër protokolli 291 i datës 10.03.2025, në fakt paraqet njoftim për ekzekutimin e vendimit të Komisionit të Disiplinor të datës 27.06.2024, pasi që i njëjti është bërë i ekzekutueshëm në momentin kur ankuesit është refuzuar ankesa e tij, ndërsa Vendimi me shifër KDI08/2024, i datës 27.06.2024 i Komisionit Disiplinor të SHKK-së është lëndë në fuqi, gjegjësisht në rrethanat e rastit konkret ky vendim ka prodhuar efekt edhe në rritjen pagës, ngase masa e shqiptuara disiplinor *“Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë tri (3) vjet”*.

Kolegji i këshillit thekson faktin se Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ka përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrimet e Zyrtarëve Publik, gjegjësisht çështjet e tilla janë normuar me Pjesën III-Kapitulli I, nga neni 20 e deri tek nenin 27, si dhe Kapitullin II të kësaj pjese, apo nga neni 28 e gjer tek neni 34, dhe krahas kësaj përcaktuar qartë edhe çështjen e përgjegjësisë disiplinore të përcaktuar me nenin 55 paragrafi 1 të njëjti ligj: *“Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”* duke u përcaktuar edhe llojet masave disiplinore varësisht nga lloji dhe natyra e shkeljes, sikurse një çështje të tillë e ka përcaktuar edhe legjislacioni i veçantë për nëpunësit civil të punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, respektivisht çështja e masave disiplinore është rregulluara edhe me nenin 58 të Ligjit Nr.08/L-131 Për Shërbimin Korrektues të Kosovës, gjegjësisht ligji respektiv e ka përcaktuar apo paraparë edhe masën disiplinore *“Ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë tri (3) vjet”*.

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit thekson faktin se Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është përjashtues ndaj Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Ligjit Nr.08/L-131 Për Shërbimin Korrektues të Kosovës, ligje të cilat trajtojnë dhe rregullojnë çështjen e themelimit dhe ndryshimit apo përfundimit dhe çështjeve të tjera administrative që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, me theks të veçantë sikurse në rrethanat e rastit konkret të nëpunësve civil me status të veçantë, sikurse janë të punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, andaj në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me shkelje të parimit të mosdiskriminimit apo barazisë, ngase nuk kemi

të bëjmë më situatë nën rrethana të njëjta juridike, pasi që ankuesit i është shqiptuar një masë disiplinore që ka parashikuar ndalimin e ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës, çështje kjo e përcaktuar me ligj material, andaj mbi këtë bazë si dhe konstatimit të dhënë si në arsyetimin e këtij vendimi, ankesa e ankuesit e datës 01.04.2025 është refuzuar si në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.573/2025**

**Atdhe GASHI**

\_\_\_\_\_  
Procesmbajtës

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

\_\_\_\_\_  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit F.F.;
- Shërbimit Korrektues të Kosovës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.